



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
**BASHKIA HIMARË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Himarë, më 29.08.2024

Nr. 68 prot.

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA  
ORGJINALI ,MBAJTUR NË MBLEDHJEN E RADHE TE MUAJIT GUSHT .**

Sot më datë 29.08.2024,ora 10:30 zhvillohet mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Himarë.  
Mbledhje e hapur.

Të ftuar administrator të njësive bashkia Himarë,kryetarët e fshatrave,drejtoritë.

Marrin pjesë këshilltarët: 1.Aleks Llazari, 2.Timoleo Gërdhuqi ,3.Dhimitër Kapaj, 4.Elisabeta Lamaj , 5.Milto Nika, 6.Gjergji Iliadhi ,7 Thodhori Foto, 8.Artan Bala. ,9.Fuat Mati.  
10.Mirka Gjiçali,11.Lenica Kocani,12.Afrovita Dhimojani,13.Thëllëza Kokaveshi,  
14.Timoleo Gërdhuqi.

Mungojnë : 1. Miltiadh Prifti, 2. Qirjako Mërkuri,3.Maks Vlasi,4.Nikolinë Laska,5. Nertila Husi, 6.Loreta Isufi. 7.Artionil Shirokaj ( pa arsye të gjithë)

Plotësohet Kuorumi këshilltarëve mbi 50%

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z.Dhimitër Kapaj.

Lexon ligjshmërinë e vendimeve të mbledhjes së kaluar,mbledhje jashtë radhe.

Zonja Silva Burbo dhe znj. Lenica Kocani kërkojnë leje .

Afrovita Dhimojani kërkon lejen e fjalës.

Kryetari këshillit : Të ishit prezent në mbledhjen e kaluar për të diskutuar rreth vendimeve të mëparshme.

Z.Timoleo Gërdhuqi : - ato projektvendime ndoshta do të ishin futur në rend të ditës mirëpo e shqyrtoi këshilli dhe e pa të vlefshme të miratoheshin. Për këto pika është bërë dëgjuesë publike dhe janë vendime që nuk cenojnë asnjë individë dhe ndaj I kemi votuar.

Z. Fuat Mati :- Në mbledhje nuk dëgjova asnjë këshilltar kundër ,juve vinit në mbledhje dhe e diskutonim.

Z.Milto Nika :- Me sa shohë këshilltarët flasin sipas interesave, këto vendime janë marrë për zhvillim ,përfaqësojnë interesat e banorëve.

**Pika 1.**

Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë.

Znj.Afrovita Dhimojani:- Për procedurë si kryetare grupi e opozitës kërkoj fjalën për të dhënë mendimin tonë.Aktet që keni miratuar jam çuar në djeni po ditën e mbledhjes me rendin e materialeve shtesë . Ne jemi njoftuar se në mbledhjen jashtë radhe do të kishte në rend dite vetëm një pikë për të shqyrtuar dhe janë shtuar edhe pika të tjera. Pse?

Kryetari Bashkisë :- mbasi na erdhi kërkesa zbatuam sipas procedurave ligjore edhe më pas e sollëm në këshill,nga miratimi këshillit erdhi dhe ligjshmëria nga prefektura dhe e kemi dërguar përsëri në ministri ( Arqilea Bollano )

Z.Fuat Mati :- Këtë pronë ja dhamë shtetit shqiptar.

Znj.Afrovita Dhimojani:- A është bërë dëgjese publike ?

Znj.Lenica Kocani :- po është bërë.

Z.Afrovita Dhimojani :- Kërkoj që çdo akt i kaluar në këshill të ndiqet penalisht.

Kryetari këshillit :- Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës për miratimin e nivelit të pagave.

Znj.Afrovita Dhimojani :- një ndër pikat është të miratohet ndryshimi i pagave ,ne e kaluam në mbledhje e mëparshme ,çfarë ndryshon ?

Drejtori Laert Mezani:- VKM jep një ndryshim në minimum përllogaritja e fondit për 2024 është ajo që i është propozuar këshillit .

Sa doli përllogaritja e pagave? Pyet këshilli

Z. Laert Mezani:- në maksimum.Për të mbuluar fondin e pagave është bërë një shtesë fondi ku përcaktohen fondet e ardhura nga qeveria qendrore në datë 12 bëhet llogaritja ndërsa tavani propozohet në maksimum.

Struktura e re është futur në ndryshimin buxhetor? Pyet këshilli.

Jo:- drejtori financës.

Ka ndonjë ndonjë pyetje :- Pyet kryetari këshillit.

Jo grupi jonë,kryetarja e grupit të këshilltarëve të pozitës.

Z.Timoleo Gërdhuqi :- ky grand kur do të xhirohet nga bashkia?

Do ta marrim nga qeveria qendrore:- drejtori L.M me ndryshimet në buxhet do të bëjmë përllogaritjen dhe do t'i nisëm korrespondencën qeverisë qendrore.

Kryetari këshillit :- Drejtoritë duhet të reflektojnë se të paguheni me 1 milion e 400 mijë duhet të jeni falenderues qeverisë,këshillit e me punën tuaj të jeni në shërbim të banorëve ,të këshilltarëve duke filluar që te mundësimin i kancelaritë e çdo gjë tjetër.

Z.Timoleo Gërdhuqi:- ky numëri i personave të punësuar që do të miratojmë do të ngelet kaq apo do të dyshojë?Numrln e cakton këshilli bashkiak

**Miratohet vendimi nr.28, datë 28.09.2024 për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e bashkisë Himarë me 14 vota pro, zero kundër,zero abstenim.**

**Miratohet vendimi nr.29 ,datë 29.08.2024 për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2024 me 13 vota pro, 1 abstenim ( Timoleo Gërdhuqi) ,zero kundër.**

**Të ndryshme.**

Kryetari këshillit lexon kërkesën e shoqatës “ Labëria” ku kërkon që sheshi i pilurit të emërtohet “ Lefter Çipa”,paralelisht vjen dhe kërkesa e Z. Pandeli Prifti ku kërkon t’i njihet vendimi i këshillit Bashkiak Himarë ku ka emëruar sheshin e Pilurit në emrin e babait të tij mirëpo prefektura e Qarkut Vlorë e ka rrëzuar këtë vendim të Këshillit Bashkiak pasi ka patur mangësi ligjore .

Znj.Afrovita Dhimojani: Kush e ka përpiluar kërkesën dhe dëgjesën publike në faqen në faqen e Bashkisë

Juristi:- nuk e kemi bërë ne njoftimin.

Kryetari këshillit :- na kanë ardhë një volum kërkesash dhe propozimesh nga shoqata të ndryshme për këtë çështje ,është shpallur edhe njoftimi për dëgjesë publike në fshatin Pilur nga bashkia ,tre propozim kërkesash ja për Lefter Çipën dhe një propozim kërkesë për Landeli Priftin .

Znj. Silva Burbo:- kur vjen një kërkesë duhet më parë të kalojë në administratën e Bashkisë edhe pastaj kalon komisionit të këshillit pra kalon në këshill ,pse të çohemi ne si këshill në pozita të tilla. Ne e miratuar .

Kryetari këshillit : - kryesia ka gabuar ,ka marrë mendim në vete,kryesia e fshatit Pilur .

Z. Timoleo Gërdhuqi:- unë propozoj të ngrihet një komision nga këshilli të kontrollojë kryetarët e fshatrave të Bashkisë Himarë për gjithë veprimtarinë e tyre.

Znj. Afrovita Dhimojani :- nesër zhvillohet dëgjesa publike për këtë çështje dhe është mirë si këshill që të shkojmë sepse vendimi do ta marrim ne.

Kryetari këshillit :- anëtarët e këshillit nga Piluri dhe të Himarës duhet të shkojnë .

Keni ndonjë gjë tjetër? Në rregull,mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mirë u takofshim në mbledhjen e radhës! ( Kryetari këshillit)

**Sekretari**

**Elena Memushaj**

